

KLAUDIN KODEA

JERONIM DE RADA SI FOLKLORIST E POET DHE NDIKIMI I TIJ TEK SHKRIMTARËT ARBËRESHË TË SHEK. XIX-XX

Jeronim De Rada lindi në një ditë të lumtur të fateve të Shqipërisë, më 29 nëndor 1814. Në këto ditë nëndori e tërë Shqipëria feston me entuziazëm dhe krenari njëzet vjetorin e çlirimit të atdheut. Në këtë atmosferë feste të madhe, ne përkujtojmë me vërim edhe figurën e Jeronim De Radës, në 150 vjetorin e lindjes, poetit të madh të "Milosaos", "Serafina Topisë"; "Skëndërbeut të pafat", këtyre veprave të para të letërsisë shqipe me dinjitet artistik dhe me përmbajtje kombëtare.

Jeronim De Rada zë një vend të veçantë në gjithë letërsinë shqipe të shek. XIX; ai është themeloni i vërtetë i kësaj letërsie me frymë kombëtare, në shërbim të ideve të luftës për çlirimin kombëtar nga imperatoria turke. Veprimtaria folkloristike dhe krijimet e tija letrare ndikuan shumë dhe hapën një rrugë krejt të re në letërsinë e Rilindjes arbëreshe të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, letërsi e ngjeshur me idetë fisnike të bashkimit të shqiptarëve dhe të luftës kundër zaptontjesve.

De Rada krijoi i pari vepra të bukura letrare me dinjitet artistik, duke mbështetur thellësisht dhe duke marrë shembëlla dhe modele nga letërsia shumë e bukur popullore arbëreshe.

Ç'ishte letërsia shqipe më 1814, kur lindi Jeronim De Rada? A kishte një letërsi shqipe me të vërtetë artistike me frymë kombëtare më 1832, kur nisi të shkruajë ai? Më 1832, kur nisi të shkruajë De Rada, më 1836, kur ai na dha veprën e parë të madhe me dinjitet artistik, në Shqipëri dhe ndër kolonitë shqiptare kishte një letërsi shqipe shumë të pasur e të bukur në gojën e popullit, po ajo ishte një letërsi e pashkruar edhe e pabotuar; ajo qarkulloi me shekuj brez pas brezi e gojë më gojë, duke kënduar gëzimet, hidhërimet dhe luftrat heroike të këtij populli gjatë shekujvet. Po mbetet gjithnjë e panjohur, sepse që e pambledhur dhe e pabotuar. De Rada, i tërhequr nga bukuritë e kësaj letërsie, i vuri veshes si barrë ta mbledhë e ta botojë, për ta bërë të njohur ndër shqiptarë dhe ndër të huaj.

Jeronim De Rada lindi në fillim të shekullit të kaluar në Italinë e jugut gjysëm feudale, të ndarë e të shtypur, atëhere kur, me idetë e revolucionit të madh frëng kishin hyrë në Itali trupat e Napolonit dhe rryma romantike. Romanticizmi bashkë me idetë revolucionare në art, solli në Itali edhe dashurinë për traditat popullore; ne e dimë se një karakteristikë e romantizmit ishte edhe dashuria për folklorin, për traditat popullore. De Rada u rrit bashkë me Xhusepe Macinin dhe me idetë e tija republikane. Edhe student 20 vjeçar, i mbushur me dashurinë e atdheut të lashtë, Shqipërisë, djaloshi De Radë u dha plot pasion pas mbledhjes së poezisë popullore. Me entuziazëm dhe vrull ai brodhi fshat në fshat, duke mbledhur nga vetë gojë e plakave dhe e të rejave arbëreshe gjithçka gjeti nga thesari popullor, këngë popullore lirike dhe epike të atyre anëve, këngë që këndoheshin nëpër vallet në ditët

e festavet, po, sidomos, ai mblodhi me kujdesin më të madh e të veçantë rapsoditë që i quajti "Rapsodi Kombëtare", rapsodi me një sfond historik, ato të ciklit të Skënderbeut, heroit tonë kombëtar.

Në këtë aktivitet të parë të një natyre kombëtare është e vërtetë se De Rada vazhdoi traditën e arbëreshëvet Gavril Darë Plakut, Andre Darës, Francesk Avatit, Belushit, e ndonjë tjetri, po as Darenjtë, as Avati nuk kishin mundur të botonin ato që kishin mblodhur, ndërsa De Rada, pas takimit që pati me Dhimitër Kamardën, u bind edhe më shumë për vlerën artistike, gjuhësore dhe historike kombëtare të rapsodivet. Ai mundi, me prestigjin personal që kishte fituar gjer atëhere, t'i vinte në botim, me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë dhe me interesimin e letrarit dhe gjuhëtarit të dëgjuar italian, në atë kohë, Nikolo Tomazeut, më 1866, në Firence.

Në krahasim me përmbytjen e rapsodive të De Radës, materialet e qishin botuar para tij Vinçenc Dorsa, Xhusepe Krispi dhe ndonjë i huaj em qëllim kurioziteti, nuk ishin gjë.

Botimi i këtyre rapsodive që një ngjarje e madhe kulturele për çështjen tonë kombëtare. De Rada i mblodhi dhe i propagandoi këto këngë si një monument ku pasqyrohesh jeta e vendit tonë në të kaluarën dhe historia zulmë-madhe e popullit tonë në shek. XV. Entuziazmi i poetit që i madh, sepse i mori ato rapsodi si pjesë të shkëputura të një poemi të madh e të plotë shqiptar, prandaj edhe në botimin e parë ai i quajti "Rapsodi të një poemi shqiptar". Vlerësimin e rapsodivet ai e bëri në veprën e vet "Parimet e estetikës". Rapsoditë u njohën nga një numur i kufizuar shqiptarësh në kohën kur u botuan, po është e sigurtë se ato i njohën Thimi Mitko dhe Zef Jubani. Pa dyshim, dukja e rapsodivet të De Radës, u hapi sytë Jubanit dhe Mitkos rreth vlerës së poezisë popullore; ai botim që për ta një nxitje në punën e tyre folkloristike. Përmbledhja e "Rapsodivet dhe poemavet shqiptare" të Zef Jubanit, të përkthyer edhe në italisht, u botuan më 1871, pesë vjet pas botimit të rapsodive të De Radës. Është kuptimplotë edhe titulli i veprës së Jubanit, ku janë përdorur pothuajse edhe fjalët e titullit të rapsodivet të De Radës: "Rapsodi dhe poema shqiptare" e titullon veprën Jubani. Vetëm 11 vjet pas rapsodivet të De Radës, doli në dritë "Bleta" e Mitkos, 1877.

Brënda në Itali, udha e hapur nga De Rada në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, në të mblodhurit e folklorit, u ndoq nga një numur i madh arbëreshësh.

Ndikimi i parë e i dukshëm ndër arbëreshët nga rapsoditë e De Radës shihet tek poeti i ri i Horës së arbëreshëvet, Zef Skiroi, i cili, duke kërkuar që të ndiqte udhën e poetit të madh, De Radës, u frymëzua nga rapsoditë e poetit të Maqës për të kompozuar rapsoditë e tija më 1887. Po për këtë do të flasim gjatë më poshtë. Veç kësaj Skiroi vetë, si u dha pas të mblodhurit të folklorit, më 1901 botoi vëllimin "Këngët popullore të Shqipërisë". Ai vazhdoi gjatë gjithë jetës duke ndjekur gjurmët e De Radës, të interesohet për poezinë popullore dhe na dha disa botime të vlefshme si "Këngët e shënjeta", po sidomos "Këngët tradicionale" në vëllimin e madh, më 1923. Zef Skiroi, duke u marrë me folklor dhe duke dashur të imitojë De Radën në krijimet e tija, u influencua nga folklori në motive dhe në figurat poetike, si do të tregojmë.

Më 1908 Mikel Markjanoi, që që edhe një kritik me vlerë i poetit dhe admironjës i madh i De Radës, bashkëfshatar i tij, duke parë vlerën e poezisë popullore, botoi një përmbledhje këngësh popullore shqiptare, ndërsa po në atë vit, doli në dritë edhe vëllimi i Spiro Dines, "Valët e Detit".

Më 1912, Anton Skura, arbëresh edhe ky, duke çmuar vlefën e rapsodivet të De Radës, që tani ishin bërë shumë të rralla edhe nëpër bibliotekat,

ribotoi, me ndonjë ndryshim, botimin e plotë të rapsodivet të De Radës në veprën me titull "Shqiptarët e Italisë dhe këngët e tyre tradicionale".

Udha e bukur që hapi De Rada në të mbledhurit dhe në të botuarit e thesarit popullor, u ndoq nga një radhë e pambaruar arbëreshësh, që vazhdon edhe sot e kësaj dite me dashuri. Kështu për meritë të De Radës së madh, ne kemi sot të botuara e të ribotuara materiale të pasura të thesarit popullor arbëresh, gjithë atë trashëguesë kombëtare me një vlerë artistike të amshuar të popullit tonë, trashëguesë kombëtare, që u ruajt me fanatizëm gjatë pesë shekujve nga vëllezërit tanë arbëreshë të përtej Adriatikut.

Kjo është merita e parë e madhe e De Radës në punën e vlerësimit të poezisë popullore, letërsi popullore që gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX u mbledh, u botua dhe u përhap mirë. Kjo letërsi e pasur popullore fillim e përhapjes së saj e ka tek rapsoditë e De Radës.

Veç letërsisë popullore shqipe, që qëndronte e pambledhur dhe e pabotuar a kishte në Shqipëri dhe nëpër kolonitë një letërsi reflekse shqipe më 1836, kur De Rada botoi kryeveprën e vet, "Milosaoon"?

Veç letërsisë së pasur dhe të bukur popullore, që nga shek. XVI kish nisur të zhvillohej, në fillim me përkthime, pastaj edhe origjinale, një letërsi shqipe mjaft e pasur, po që nga shek. XVI gjer në shek. XVIII ajo që një letërsi me përmbajtje ose krejt fetare ose mistiko-fetare, moralizonjese fetare; në shek. XVI-XVII shkrimet fetare qenë pothuajse të gjitha përkthime, pa një vlerë artike letrare.

Në shek. XVIII lindi dhe u zhvillua një letërsi shumë e pasur në katër anët e Shqipërisë nga shkrimtarët me ndikim të kulturës turko-arabe-persiane, po që nuk pa gjë të botuar para 1888, kur për herë të parë nga gjithë ajo letërsi, Vretoja botoi "Ervehënë" e Muhamed Kyçyikut.

"Divanet" e Nezim Frakullës, vjershat e Hasan Zyko Kamberit qarkulluan pothuaj në të katër anët e Shqipërisë gojë më gojë ose të kopjuara me dorë, pa u botuar në një libër që të njiheshin dhe të luanin rolin e tyre.

Edhe letërsia arbëreshe e shek. XVIII bëri një hap shumë të madh përpara, duke pasuruar format e poezisë, po, si me "Gjellën e Shën Mërisë" të Varibobës edhe me aktorë të tjerë të shumtë të këtij shekulli, ajo mbeti gjithnjë me përmbajtje fetare. E gjithë kjo letërsi që u zhvillua në poezi, ashtu si shkrimet bejtexhinjet mbeti e pabotuar gjer në fillim të shek. XX, kur pjesën më të madhe të saj e botoi Zef Skiroi senior në veprën e tij të njohur "Canti tradicional" më 1923. Ajo që e tëra me përmbajtje fetare, ndonse Nikollë Keta, që vdiq më 1803, kishte shkruar ndonjë vjershë të bukur me përmbajtje laike. Kështu, e gjithë letërsia shqipe e bejtexhinjet dhe e arbëreshëve të Italisë në shek. XVIII, s'pati asgjë nacionale. Nezimi u këndoi trëndafilave dhe bilbilave, Hasan Zyko Kymberi i këndoi jetës së ngushtë të fshatit, Muhamed Kyçyiku u frymëzua nga letërsia mistike-biblike-fetare

Kundra kësaj letërsie fetare, pa një përmbajtje të dobishme nacionale, i pari që ngriti zërin në historinë e letërsisë shqipe që padyshim Jeronim De Rada, kur boton disa fragmente të veprës së Varibobës dhe kur çmon veprën e aktorit të Mbusatit. Kundra kësaj letërsie fetare, për një letërsi të re me përmbajtje të shëndoshë dhe më gjuhë të pastër shqipe, De Rada u shpreh kështu, kur flet për veprën e Varibobës: "Fare ajo Gjellë i prothën ndo mallit; ndo nevojë së ditës sot. Arbërit i ljipsen sot gjëra e të bënave gavnare të prindërvet në një vantilje bashkë. Ljipset të buthtomi të foljët që gjëria jonë sipret ka gola e ëmmavet të huaja, po pati ka ëmma e saj".¹⁾ Këto fjalë të

1) "Fjamuri i Arberit", 1885, nr. 3.

De Radës plot kuptim, në gjuhën e sotme shqipe tingëllojnë kështu: "Ajo Jetë s'i vlen fare as dashurisë, as nevojës së ditës së sotme. Shqipërisë i duhet sot gjëra të të bënavet heroike të prindërvet nën një flamur bashkë. Duhet të tregojmë të folurit që gjëria e jonë nuk pret nga goja e nënave të huaja, po atë që pati nga nëna e saj".

Pra De Rada kërkon të shkruhen vepra me përmbajtje nga historia e lavdishme e vendit me një gjuhë të pastër shqipe. Ai kështu u shpreh kur gjykoje veprën e Varibobës, po si do t'i kishte gjykuar vallë po t'i kishte njohur "Divanet" e Nezimit, vjershat e Hasan Zyko Kamberit dhe poemat e Muhamet Kyçyikut, vepra të gjitha të mbushura me turqizma, arabizma dhe persizma, sa s'i kupton njeri, që nuk i din këto gjuhë?

De Rada, duke u nisur nga këto dy parime, përmbajtje nga e kaluara e lavdishme dhe një gjuhë shqipe të pastër, nisi të shkruajë veprat e veta dhe i dha letërsisë shqipe të varfër gjithë ato shkrime që dijmë.

Për të kuptuar gjendjen e letërsisë shqipe në kohën kur nisi të shkruajë De Rada, është interesant një krahasim: Vingens Dorsa, në veprën e vet "Shqiptarët" — kërkime dhe mendime — në kapitullin ku flet për zhvillimin e letërsisë shqipe gjatë shekujve, mezi mundi të numurojë, në vjetin 1847, kur botohet vepra e tij, 7-8 vepra të letërsisë shqipe të atëherëshme; duke futur në atë numurim të tij, "Doktrinën e Krishterë" të Pjetër Budit, "Fjalorin" e Frano Bardhit, "Gramatikën" e Da Leçes, "Gjellën e Shën Mërisë" të Varibobës, duke përfunduar me këngët e "Milosaos" e të "Serafinës" së De Radës dhe "Këngëtaren" shqip të Francesk Anton Santorit. Pak më shumë se gjysëm shekulli pas veprës së Dorsës, më 1903, letërsia shqipe është pasuruar me më shumë se 30 vepra vetëm me repertorin e veprave të Jeronim De Radës. Po, Jeronim De Rada, gjatë më se gjysëm shekulli të prodhimtarisë së tij letrare, e pasuroi mendimin shqiptar me vepra poetike, vepra teorike rreth gjuhës dhe vjetërsisë së popullit shqiptar, me shkrimet e tija rreth artit e sociologjisë.

Aktiviteti i parë i De Radës në të mbledhurit e rapsodivet kombëtare ka një rëndësi të madhe për drejtimin letrar të tij të mëvonshëm, për përmbajtjen e veprave, për motivet e poezisë së tij, për gjuhën dhe për vargun që përdori gjithnjë në shkrimet e veta. Në këngët popullore, poeti i ri, zbuloi një botë të re frymëzimesh. Ato këngë ngjallën tek ai dashurinë për vendin e të parëvet dhe për gjuhën shqipe dhe, me shumë të drejtë vë në dukje Gualtieri, se De Rada kishte nisur të shkruante italisht që më 1832, po, pas zbulimit të rapsodivet, folklorit shqiptar, ai hoqi dorë nga italishtja dhe u dha të shkruajë gati gjithnjë shqip veprat e tija letrare, gjithnjë në trajtën e poezisë popullore, në vargje shtatë dhe tetë rrokësh trokaike të rapsodivet.

Në ato poezi popullore, De Rada i pari zbuloi një botë të re frymëzimesh aty gjeti të skalitur të kaluarën zulumëmadhe të një populli, gjeti të skalitur luftën titanike të popullit shqiptar, për të mbrojtur vendin kundra hordhivet barabare të Azisë në shek. XV. Dhe De Rada, duke nisur nga poezia popullore, e bëri temë të të gjitha veprave letrare këtë të kaluar të popullit shqiptar. Kjo është merita e dytë e madhe e tij. Ai është i pari poet i madh i kombit, i pari poet i madh popullor që do të frymëzohet nga poezia popullore, ashtu si do të bëjnë në shekullin e tij shumë poetë romantikë demokratë revolucionarë të popujve të tjerë të shtypur në Europë, si Miçkjevici në Poloni, Botevi në Bullgari, Petofi në Hungari.

I ndezur nga dëshira që të krijonte një letërsi me përmbajtje të idevet kombëtare, me një gjuhë të pastër, ndryshe nga veprat e gjertanishme, De Rada, më 1836, botoi në Napoli "Këngët e Milosaos". Kjo vepër hapi pa dyshim një rrugë të re në historinë e letërsisë shqipe, sepse me atë roman

letërsia shqipe, nga një letërsi me përmbajtje fetare apo mistiko-fetare, pa vlera të mëdha artistike, tani me veprën e De Radës, u bë një letërsi laike, njerëzore, me vlera të shquara artistike. Në këtë veper De Rada, poet i ri e i madh i kombit, ngriti zërin plot optimizëm rreth së ardhmes së Shqipërisë dhe të popullit shqiptar. Me gojën e heroit të tij Milosaos, De Rada u thirrë shqiptarëve dhe gjithë botës me një zë krejt të ri, qysh në kohë të Skënderbeut e të Barletit:

Erth dita e Arbërit!

Në atë roman poeti nuk u këndoi vetëm dashurikçavet të tija, sikurse jemi mësuar të dëgjojmë nga kritika, por shprehu, si asnjë tjetër para tij në letërsinë shqipe, edhe ndjenjat e veta rreth dashurisë së atdheut. Milosaos djaloshit të ri, nuk i rreh zemra vetëm për Rinën, po edhe për Arbërin. I pari në kohët moderne, në letërsinë moderne shqipe, De Rada qysh më 1836, feli për një flamur të Shqipërisë:

Fatmirosh ai që na dolli
Mu si fjamur i Arbërit!

Pas "Milosaos, së De Radës, kjo dashuri e atdheut, e Arbërit, invadoi pothuajse të gjithë poezinë arbëreshe të shek. XIX. Është i qartë pra ndikimi që ushtroi kjo veper e parë arti shqiptar ndër shkrimtarët arbëreshë që erdhën pas De Radës: i tillë është Gavril Darë i Riu në "Këngën e sprasme të Balës", një xhevahir tjetër i letërsisë arbëreshe. Nik Peta i Darës e dashuron shumë Marën e vet, po më përpara, si Milosao, edhe ai, do të vejë të luftojë për vendin dhe pastaj të vijë e të gëzojë dashurinë, madje si njeri si tjetri mbi altarin e atdheut sakrifikojnë dashurinë e të dashuravet të tyre; që të dy lenë të fejuarat dhe venë e luftojnë në parë kundra armikut. Si Milosao i De Radës, që vdiq në luftë edhe Nik Peta dhe Pal Golemi të Darës, do të vdesin në luftë për mbrojtjen e atdheut. Milosao bije në sheshin e betejës me armë ndër duar për nderin e Shqipërisë. Figura e tij fisnike na kujton figurat e pasura të epikës legjendare të Nik Petës, Pal Golemit, Miloshinit e Pjetër Shinit, Rada Vanit etj. Pas shembullit të De Radës, që i futi në letërsinë reflektive, këto figura të epikës legjendare invaduan letërsinë reflektive shqipe të shek. XIX me Darën, Skiroin, Kozmo Seremben etj.

Si e ka vërejtur me shumë të drejtë Mikel Markjano, kritik shumë i aftë i gjithë veprës së De Radës, do të ishte interesante të bëhesh një studim në mes të vijës së romanit të "Milosaos" së De Radës dhe të "Mili e Hajdhisë" të Zef Skiroi senior, për të parë ndikimin e poetit të Horës së arbëreshëve në këtë veper të poetit të Maqës.

Zef Skiroi është poet i madh ndër shkrimtarët e fundit të letërsisë së Rilindjes arbëreshe, që duke ndjekur traditën e De Radës e të Darës, këndoi të kaluarën e ndritur të shqiptarëve dhe shprehu mallin e pashuar të arbëreshëve në dhe të huaj për vendin e largët. Të kaluarën e shprehu në "Rapsoditë" ndërsa mallin e arbëreshëve në poemën idilike "Mili e Hajdhia" dhe "Te Dheu i Huaj", poemë liriko-epike.

"Mili e Hajdhia" është një poemë liriko-dramatike, ku si në Milosaos e De Radës, dy të rinj arbëreshë në dhe të huaj, dashurohen, por i shqetëson edhe dashuria dhe fati i atdheut të largët nën turqit. E gjithë poema "Mili e Hajdhia" është një imitimi i "Milosaos" së De Radës. Megjithatë De Rada protagonistin na e dha nga Shkodra e shek. XV, nganjëherë, ai e harron këtë dhe na përshkruan botën arbëreshe, fshatin arbëresh; këtë bëri edhe Skiroi te "Mili e Hajdhia".

Si në "Milosaon" e De Radës, Zef Skiroi deshi të imitonte poetin e Maqes edhe në fundin e poemës së tij "Mili e Hajdhia", duke bërë që të vdesin të dy protagonistët, me këtë ndryshim që në "Milosaon" para trimit vdes e dashura, Rina, kurse në "Mili e Hajdhia" vdes Mili para Hajdhisë. Edhe Mili në çastin e vdekjes, si Milosao, merr me vehte dhëmbjen që nuk ka mundur të çlirojë atdheun e largët nga turqit, po ndërsa Milosao i De Radës vdes, si ka plotësuar detyrën e atdheut me armë në dorë, Mili i Skiroit vdes kot, pa asnjë qëllim, nga vdekje e zakonëshme. Kështu me të drejtë Mikel Markjanoi tha se poema e Skiroit, "Mili e Hajdhia" "finisce in un tetro funerale".

Poema "Mili e Hajdhia" e Skiroit është, siç thamë, një poemë liriko-dramatike ku janë shprehur ëndërrat e poetit sa ishte i ri. Aty këndohet me një nostalgji prekëse atdheu i largët dhe lavdia e dikurshme. Dhe këto ëndërra janë të ndryshme: Milit dhe plakut Dodë, që shprehin në poemë ndjenjat e poetit, u del përpara koha e kaluar, e shkëlqyer, koha e Skënderbeut, në të cilën shqiptarët të bashkuar luftuan kundra armikut turk dhe e mundën atë. Pastaj, në antitezë me këtë të kaluar, u del përpara e tanishmja e hidhur, me atdheun e robëruar; këto ëndërra, si në rapsoditë që kishte botuar që më 1887, e shpijen poetin sa në Krujë, sa në Himarë, në Lesh a në Shkodër, qendra të rezistencës shqiptare në Shqipërinë e mesme, të jugut dhe të veriut. Po në poemat e De Radës "Milosao", "Serafine Topia", "Skënderbeu i pafat", "Një pasqyrë e jetës njerzore", ku zhvillohen veprimet? Siç do të shohim, në të katër anët e Shqipërisë.

Është thënë se De Rada, me "Milosaon", u dha bashkëatdhetarëve të vet veprën e parë të artit refleks, që s'ishte shkruar kurrë para tij në gjuhën shqipe; kësaj shprehje ne do t'i shtojmë edhe këtë: De Rada me "Milosaon" e tij e ngriti letërsinë shqipe në një nivel ndërkombëtar, ai i bëri të ditur botës mbarë gjeninë krijonjëse artistike shqiptare. Nuk do të citoj këtu gjëra që dihen tanimë, për të vërtetuar se si u vlerësua vepra poetike e De Radës nga figura të njohura të Europës të shek. XIX në fushën e letërsisë dhe të kulturës në përgjithësi, po do të them se, duke i marrë për brazë gjykimet e tyre, letërsia shqipe, kultura shqiptare, për meritë të De Radës, arriti kulme kaq të larta europiane, sa ajo tërhoqi vëmendjen e gjithë personaliteteve të njohura të Europës në atë kohë.

De Rada, duke nisur nga poezia popullore, futi për herë të parë në poemat e tij, pra në gjithë letërsinë shqipe, episode të historisë sonë të shek. XV ai futi emra të epikës historike si Skënderbeun, Sulltanin, Ballabanin, Moisiun, Lekë Dukagjnin e tij, futi emra të epikës legjendare si Miloshinin, Radavanin, sidomos kjo e fundit u bënë figurë e preferuar e tij; këtë figurë, duke e marrë nga epika legjendare ai e pasuroi kaqë shumë, sa në të, si e thotë Mikel Markjanoi, krijoi një tip të denjë për Ajaksin e Homerit. De Rada veç kësaj për herë të parë në letërsinë refleks shqipe, futi motive dhe figura poetike nga poezia e bukura popullore. Po pas shembullit të tija s'e bëri këtë gjë edhe Gavril Darë i Riu me figurat historike të Skënderbeut, Ballabanit, Moisiut, Sulltanit, me figurat e epikës legjendare të Nik Petës dhe të Pal Golemit? Si vepra e De Radës edhe ajo e Darës është plot motive dhe figura poetike të bukura të poezisë popullore arbëreshe. Po këtë gjë a nuk do ta bëjë edhe Zef Skiroi, i cili që në veprat e para ndoqi me besnikëri krijimtarinë poetike të De Radës?

Këtë do të bëjë edhe poeti i fundit i Palac Adrianit, Frano Gllaviano Krispi, vepra e të cilit, "Mbi malin e truntafilevet" është botuar kohët e fundit. Aty duket menjëherë, se poeti, duke ndjekur gjurmët e De Radës, të Dares e të Skiroit, e ka shfrytëzuar shumë poezinë popullore në motive

dhe në figura, po pa arritur mjeshtërinë artistike të asnjërit. Kështu, për meritë të De Radës, ndikimi nga poezia popullore arbëreshe në veprat e letërsisë reflekse arbëreshe, u bë një vijë e zakonshme që dha një rezultat të shkëlqyer.

Jeronim De Rada është poet i madh, që la vazhdë në letërsinë arbëreshe, sepse i pari e ngriti letërsinë shqipe, të varfër gjer në kohën e vet, me një përmbajtje gjer atëhere fetare, në një letërsi njerëzore, me vlera të larta artistike, duke e shkëputur atë përgjithmonë nga feja, nga përmbajtja mistikofetare e bejtexhinjëvet. Ai ka meritën se i pari u foli shqiptarëvevet dhe të huajvet për një të kaluar zulummadhe shqiptare në shek. XV, kur shqipëtarët dhe Shqipëria akuzoheshin nga armiqtë se "s'kishin një kombësi, se s'kishin një lëndë, se s'kishin një kulturë kombëtare e se ishin "qitabsëzë".

Mund të shkruhen monografi të tëra për të treguar ndikimin e Gavril Darë të Riut dhe të Zef Skiroit senior nga epika legjendare dhe nga epika historike e shek. XV, mund të shkruhet shumë se si këta dy poetë, duke ndjekur rrugën që i pari hapi De Rada, e pasuruan edhe e zbukuruan letërsinë shqipe arbëreshe, duke marrë nga poezia popullore arbëreshe personazhe, motive dhe figura të tëra dhe ajo që është për t'u theksuar, këtë gjë ata e bënë me art, pa asnjë artificialitet dhe jo si Frano Gllaviano Krispi, që me atë përsëritje të po atyre motiveve popullore, e bën poemën monotone dhe të mër-zitëshme.

Është folur dhe është shkruar shumë rreth rolit që kanë luajtur rapsoditë e De Radës në opinionin e Europës, rreth rëndësisë që patën ato për të vënë në dukje nacionalitetin shqiptar, po nuk është thënë asnjë fjalë se ç'ndikim ushtruan ato në letërsinë, veçanërisht tek Zef Skiroi senior. Rapsoditë e De Radës, Skiroi i kishte njohur në dy botimet, kur ishte ende djalë i ri; ata u botuan me 1866 në vëllim të veçantë në Firence dhe një botim tjetër në faqet e Fjamurit pas 1885. Duke parë suksesin e rapsodivët të De Radës, i tërhequr nga bukuritë e tyre, hyri dhe hartoi në modelin e tyre, rapsoditë e tija shqiptare. Nga një analizë e "Rapsodive shqiptare" të Skiroit, në përmbajtje, në personazhe e figura, del se ato janë shumë të ngjashme me ato që kishte botuar De Rada.

Që u influencua nga vepra e De Radës, këtë Skiroi e tregon në parathënien e rapsodive të veta, ku thotë se libri i De Radës "është i përbërë nga shtatëdhjetedy rapsodi dhe është i ndarë në tri pjesë:

1. Shqiptarët kur ishin të lirë.
2. Shqiptarët në luftë me turkun.
3. Shqiptarët të mundur dhe në mërgim".

Dhe Skiroi vazhdon të analizojë përmbajtjen e çdo pjese të rapsodivët të De Radës.

"Pjesa e parë që ka njëzet këngë, na jep në një mënyrë të habitëshme zakonet e një populli kalorës, kur kalorësia kishte vdekur në pjesën tjetër të Europës, të një populli të fortë e të lirë, të egër në urrejtje, të lartë në punë të dashurisë, mikpritës dhe besimtar gjer në bestytini, luftëtar dhe poet njëkohësisht".

"Pjesa e dytë, edhe ajo prej njëzet këngësh, shpreh urrejtjen dhe përbuzjen e shqiptarëvevet kundra turqëvevet që kishin përta vendin; është rrëfimi gjenial i të gjitha heroizmvët, i të gjitha fitorevet të luftës për independencë".

"Pjesa e tretë që ka tredhjetedy këngë, është frymëzuar nga brengat, nga dëshirat dhe nga malli i mërgimtarëvevet; aty është shprehur gjega e patregueshme e një malli të pafund, të bashkuar me besimin e verbër; aty është shprehur besimi në kthimin e afërt, në lumturinë e pashmangëshme, në ringjalljen e kombit".

I dhamë këto citate të gjata, për të treguar se sa e kishte entuziazmuar ajo përmbajtje poetin e ri njëzetvjeçar dhe se si hyri e shkroi edhe ai rapsoditë e veta, me atë përmbajtje dhe me atë trajtë në përgjithësi. I dhamë këto citate të gjata, për të treguar se si Skiroi ndoqi De Radën edhe nga ana e jashtëme në paraqitjen e rapsodive të veta dhe në ndarjen e tyre në pjesë, se edhe Skiroi, si De Rada, i ndau të vetat. Poeti është i ri, po del për herë të parë para publikut, ka frikë nga kritika, gojë të liga eventuale don t'i mbyllë me modelin e një mjeshtri të madh, me një vepër që kishte bërë kaqë bujë e që kishte qenë pëlqyer kaqë shumë. Ai don të dalë para publikut me modelin e një mjeshtri të madh që kishte fituar tanimë emër në të katër anët, prandaj Skiroi thotë se edhe ai i ka ndarë në tri pjesë rapsoditë e veta: "Këto rapsodi të reja edhe unë i kam ndarë në tri pjesë, duke u bazuar në natyrën e poezisë popullore arbëreshe, e cila me simbole dhe me alegori i mbulon si me një perde ngjarjet e një interesi të përgjithshëm; në pjesën e parë vura gjashtëmbëdhjetë prej tyre dhe më të shkurtërat, në mënyrë që të formojnë një epope të vogël të një lloji krejt të ri, duke mos pasur këngët në mes të tyre asnjë lidhje të dukshme vazhdimësie, duke bërë fjalë për rrethimin që i bëri Sulltan Mehmeti i dytë Krujës më 1466".

"Pjesa e dytë është përbërë nga nëndë këngë të gjata, të pavarura njëra nga tjetra dhe e treta është përbërë nga pesë hymne, që mua më duken shumë të lashtë".

Dihet se "Rapsoditë" e Skiroit janë të tijat origjinale, po, duke mistifikuar, i paraqiti ato si të zbuluara nga ai, ashtu "të harruara nëpër karta të vjetra". Me këtë ai donte t'i thoshte publikut se edhe ato të tijat ishin si ato të De Radës, që kishte mbledhë dhe botuar poeti i Maqës. Pra, në hartimin e "Rapsodive" të Skiroit, duket qartë imitimi i rapsodivet të De Radës, po vepra e tij nuk pati bukurinë dhe shijen e rapsodivet të De Radës; ajo nuk pati as pritjen që u bëri publiku atyre që botoi De Rada. Megjithatë kjo vepër e parë e Skiroit ka rëndësi për të na treguar poetin që në të ritë ndoqi udhën e De Radës së madh.

Në pjesën e parë të rapsodivet Skiroi nuk është larg as nga ndikimi i Milosaos së De Radës, kur poeti don të përkrahë ardhjen e turqëve dhe rrethimin e Shqipërisë nga forcat e tyre; ai krijoi shumë herë skena analoge me ato të Milosaos:

De Rada në këngën e V të Milosaos jep alarmin ndër shqiptarët, duke thirrur, se anijet turke kanë rrethuar bregdetin shqiptar, erdhi dita e Arbërit. anbaroi Shqipëria:

Çë të veen ndë deitit

Noeriit zëmëra imme?

— Zbardhëtin aniizit . . .

Erth ditta e Arbërit!

Një situatë të tillë jep edhe poeti i Horës në alarmin se po vijnë turqet të rrethojnë Krujën:

Bumbullisi tas i kekj.

Monostrofi nd'aanszë Krojës.

Jo se ngch'icët një monostrof,

Tçë nd'aan Krojes bumbullis,

Po të huajt tçë ju sulën!

Mistifikimin që u bëri Skiroi rapsodivet të veta, duke na i paraqitur

si të gjetura, e hëngër kritika e kohës. Ja se ç'thotë Mikel Markjanoi për to: "Rapsoditë e tija janë botime të gjetura, të bukura e të modernizuara".

Zef Skiroi senior, poetit të Milosaos i kushtoi edhe dy vjersha: njerën më 1898, botuar në "Nazione Albanese", kur De Rada ishte tani më plak 84 vjeçar, i mbetur fillkat vetëm. Në këtë vjershë Zef Skiroi e njeh hapur rolin e De Radës, njeh se si ai i ka ndezur të tjerët me këngën e tij; prandaj poeti i thotë:

Rro për ata që vetëm ty të kanë
Tani në botë pa kuptuar asgjë,
Se si të zbjerrë në një pyll po janë,
Në aqë të vegjël e pa ndihmë i lë.

E rro për të tjerët bij, trima shqiptarë,
Të cilëvet u rrite ndër të huajt hje.
Me këngën tënde ndeze ata më parë
E gjithë të mbanjen si shënjtor mbi dhe.

Vjershën e dytë Skiroi ia kushtoi vdekjes së poetit, botuar më 1904 në "Kalendarin Kombiar". Në atë vjershë, si fton shqiptarë e Shqipëri që të qajnë për humbjen e madhe, Skiroi trillon një dialog me pëllumbin e De Radës, që ka ardhur dhe kërkon poetin dhe këngën e tij. Skiroi i thotë realitetin pëllumbit: Poeti vdiq. Dhe Skiroi i lutet që të mos këthehet më as në Temp, as në Maqë, po të qëndrojë aty në shtëpi të tij, si i premtun se do ta ushqejë mirë, mjafton që pëllumbi ta frymëzojë. Ja se si në këtë vjershë të Skiroit poezia arbëreshe kaloi simbolikisht, me pëllumbin e De Radës, nga Maqa, nga De Rada, në Horën e arbëreshëve, tek Skiroi:

Moj ti vidhe, pend'e bardhë,
Zoti jit u ftoh si mardhë,
Zoti jit, aili! u kjëllua,
Si hërnar pa vaj u shua.
Po nani mos u nkëthe
Ti ndë Temp e mos na le;

Fluturo te shpiza jime,
Të gjesh mall e përgëzime;
Të shkosh jetën bashkë me mua,
Të t'ushkenj e të të dua;
Të më rrosh e pakujdes,
Si një vidhës e pafës,
Të më kesh e nder e hje,
Si në Makj e si në Te.

Jeronim De Rada nga 1872-1884 botoi në 5 vëllime poemën epike "Skënderbegu pafaan". Qysh në atë kohë, për meritë të De Radës, figura e Skënderbeut dhe e epokës së tij u bë burim frymëzimi e gati gjithë letërsisë së Rilindjes arbëreshe dhe e gjithë letërsisë kombëtare shqiptare.

Dihet, se në të gjithë letërsinë e Rilindjes sonë, figura e kreshnikut të Krajes u bë simbol i të gjitha luftave heroike të shqiptarëve kundra turkut. Shkrimtarët e Rilindjes, duke evokuar atë figurë, deshën të ngjallin ndër

shqiptarët seditrën kombëtare, deshën t'u tregojnë bashkëatdhetarëve të tyre epokën zulumëmadhe të popullit shqiptar në shek. XV.

De Rada, që e gjeti epokën dhe figurën e Skënderbeut tek Barleti, po sidomos në rapsoditë, ka meritën i pari që e futi dhe e këndoi në letërsinë reflekse shqipe atë figurë dhe atë epokë në aspektet e luftës për liri. Ai i dha kështu letërsisë shqipe për herë të parë poemën epike. Pas poemës së De Radës "Skënderbegu i pafaan" nuk gjen shkrimtar shqiptar a arbëresh që të mos i ketë kushtuar të paktën një vjershë kreshnikut tonë të shek. XV. Këtë e bëri edhe Kristoforidhi, që s'ishte poet, duke i kushtuar atij një poezi të vogël, në tregimin "Gjahu i malësorëve". Kështu, në të gjithë atë poezi të Rilindjes sonë kushtuar Skënderbeut dhe epokës së tij, ne nuk mund të mos shohim ndikimin direkt, sidomos tek arbëreshët, të poetit të Maqës. Rreth epokës dhe figurës së Skënderbeut, poema të mëdha e të bukura shkruan edhe Gavril Darë i Riu si "Kënka e Sprasme e Balës", Zef Skiroi senior "Te Dheu i Huaj", sidomos në botimin e dytë, 1940. Rreth asaj epoke dhe figurës së Skënderbeut ka mbetur e pabotuar një letërsi e pasur në poezi nga arbëreshë të tjerë. Edhe sot e kësaj dite mbetën të pabotuara poemat voluminoze të Kozmo Serembes, për të cilin dëjmo se na ka lënë një poemë të gjatë prej rreth 19 mijë vargësh, në 22 këngë, me titullin "Këmbana e Krujës". Në këtë poemë, me personazhet e epikës legjendare që ka futur poeti, ndihet ndikimi direkt i De Radës. Një poemë të tillë të gjatë të pabotuar na ka lënë edhe Bernardo Bilota, poeti arbëresh nga Frashniti, "Shpata e Skënderbeut", poemë që sot ruhet në dorëshkrim nga nipi i poetit, Papas Emanuil Jordani, auktorit të fjalorit të fundit të arbëreshëve të Italisë.

Nuk mund të themi se hartimi i poemës së Naimit rreth Skënderbeut, që një ndikim nga De Rada; por sidoqoftë, vepra e Naimit u bë një libër i dashur për shqipëtarët, qarkulloi dorë më dorë si një ungjill i shqiptarizmit dhe e popullarizoi mirë epokën dhe figurën e Skënderbeut në Shqipëri (se vepra e De Radës u njoh vetëm nga një rreth i ngushtë shqiptarësh në emigracion). Sa efekt kishte bërë "Historia e Skënderbeut" e Naimit ndër shqipëtarët, na e thotë Spiro Dine në parathënien e veprës së vet më 1908: "... Kush prej shqiptarëve s'ka kënduarë historinë e Gjergj Kastriotit (Skënderbeut) nuk mund të bëhet mëmëdhetar i vërtetë, se këtu do të shohë, do të çuditet e do të mahitet me mëndjen e me trimëritë që kanë rrëfyer stërgjyshërit tanë dhe kështu ka me lavdëruar Zonë që u linte shqipëtar dhe, kur të sjellim këtë emër ta kemi për lëvdatë, e jo si ca quraveçë dhe të humburë që humbasin në lëkurën e tyre, edhe e kanë për turp të quhen ç'janë, po fshihen si miza nënë bishtin e kalit. Duke kënduarë pra këtë histori, dhe duke qarë dhe duke derdhur lot, psherëtinja dhe thoshnja: "Ah! e varfëra Shqipëri! O vatra e trimërisë; ku paske qënë dhe ku gjënde sot!"

Kritikët ekzigjentë e kritikuan De Radën, ndër ta edhe Markjanoi, se na dha një poemë pa unitet vendi, veprimi dhe kohe, duke qënë vepra një grumbull këngësh të shkëputura, pa një aksion qëndror. Këtyre kritikëve ne do u përgjigjeshim, se uniteti i veprës është idea e poetit që deshi të këndonte, qoftë edhe në disa këngë të palidhura, episode të ndryshme heroike të rezistencës së popullit shqiptar kundra hordhive aziatike në shek. XV në Shqipëri. Si mundesh De Rada të respektonte unitetin e veprimit, kur betejat kundra turqëve s'kishin kurrë të mbaruar në Shqipëri? Si mund të respektonte De Rada unitetin e vendit dhe të kohës, kur para se të mundesh një pasha me ushtritë e tija, dërgohesh një tjetër me një ushtri edhe më të madhe se e para? Turqit na vinin nga të gjitha anët, nga deti e nga toka, nga jugu e nga veriu. Duke bërë që të zhvilloheshin veprimet në Dibër, Elbasan, Janinë, Shkodër dhe në një kohë të gjatë e të pacaktuar, poeti ka dashur të na

thotë, se lufrat kundra turqëvet s'patën kurrë të pushuar dhe se vala e luftës kishte përçarë të gjithë Shqipërinë, nga lindja në perëndim, nga jugu në veri. Sidoqoftë këto këngë, qofshin edhe të palidhura, na japin aspektin e jetës shqiptare në luftë kundra armikut. Në atë poemë, me ato këngë, qofshin edhe të shkëputura, De Rada krijoi në letërsinë shqipe skena madhështore që s'ishin parë në epikën tonë, krijoi personazhe të fuqishme burrash e grashë, si Rada Vami, Imotoe, Miloshini, Vantisana, që e pasuruan letërsinë shqipe si asnjëherë.

Poetët që erdhën pas De Radës e që kënduan si ai epokën dhe figurën e Skënderbeut, e patën parasysh këtë kritikë dhe na dhanë vepra më organike, si *Đara te "Kënga e Sprasme e Balës"*, *Skiroi "Te Dhe i Huaj"*.

De Rada, duke zbatuar parimin "vepra heroike, me gjuhë të nënës së vet" u bë shëmbëll për të gjithë shkrimtarët arbëreshë të shek. XIX; e gjithë poezia epiko-lirike e De Radës qe esencialisht patriotike. Veç veprave të Darës e të Skiroit, edhe vjershat me të shumta të Zef Serembes, të cilin kritika e mëparëshme e ka parë vetëm si poet të poezisë erotike, si një poet të dashurisë pa pafat, janë patriotike, të një patriotizmi të ri, që atij i mësoi De Rada në bangot e kolegjit të Shën Mitrit. E shumta nga të 40 poezitë e Frano Gllaviano Krispit, veç poemës "Mbi Malin e truntafilevet", kanë përmbajtje patriotike, që kënduan mallin e arbëreshëve në dhe të huaj dhe çlirimin e Arbërit nga "Kjeni Muskumend".

Në këtë pikë një përjashtim bën Françesk Anton Santori, në veprat e të cilit është zor të gjesh atë notë të përgjithëshme që e përshkon letërsinë arbëreshe të shek. XIX, d.m.th. notën e atdheut të lashtë të zaptuar nga i huaji. Po tek ai ndryshon puna, se Santori qe prift; atë e preokupuan më tepër problemet shoqërore të Kalabrisë, brigandazhi dhe zakoni i shëmtuar i të marrurit të gjakut, të cilat u mundua t'i vejë në dukje dhe t'i luftojë, më tepër me një moral fetar.

E gjithë letërsia arbëreshe e shek. XIX pati si tematikë dashurinë për gruan, dashurinë për atdheun e lashtë e të largët, po të robëruar nga i huaji. Këta elementë i solla i pari në letërsinë arbëreshe Jeronim De Rada; ai solla pa dyshim një kthesë në letërsinë shqipe, se e pasuroi atë me ide të bukura e fisnike, duke pasur në të gjitha veprat e tija poetike si ide qëndrore, çlirimin e atdheut të robëruar. Ai e pasuroi letërsinë shqipe në gjini, trajta e figura, që s'ishin parë tjetër herë në letërsinë reflektive shqipe, duke na dhënë romane në vargje, drama, poema epiko-lirike, të gjitha gjini që lindin për herë të parë në letërsinë shqipe të shek. XIX. De Rada na dha vepra me ide kaqë të avancuara për kohën, sa që botimi i tyre shqetësoi autoritetet burbone (në Italinë e jugut feudale), të cilët i dhanë urdhër censurës të ndalonte botimin e "Serafine Topisë" më 1839. Ajo u botua vetëm më 1843.

De Rada, i pari në letërsinë shqipe reflektive, krijoi tipin e gruas heroinë, me seder kombëtare, që ai e kishte gjetur kaqë shpesh në rapsoditë popullore. De Rada në Milosaon krijoi tipin e vajzës fshatare, ashtu të thjeshtë e të drojtur në dashuri, tipin e gruas që din të rrisë me pëkulë foshnjën e vet, tipin e gruas që din të dashurojë burrin. Këtë figurë ai e pasuroi edhe e zburkuroi më shumë në poemën "Serafine Topia". Në Milosaon ai krijoi figurën e motrës që kujdeset për vëllanë, figurën e nënës, gruas fisnike shqiptare, që për herë të parë në letërsinë reflektive shqipe ndihet t'i flasë të birit, kur e përcjell për luftë, duke i uruar që të sjellë një ushtri fitimtare dhe t'i shpëtojë ato vende nga i huaji. Pas De Radës, "Ervehes" së Muhamed Kyçyikut, me atë moral mistiko-fetar oriental që i shtrohet fatit në atë mënyrë të përulur, ia zunë vendin në letërsinë e pasur arbëreshe të shek. XIX, një tok grashë heroina të vërteta. Rinës e Serafinës së De Radës iu shtuan Mara

trimësheshë e Darës, Hajdhia, Donika, Vasiliqia e Skiroit, Shqeva e Gllaviano Krispit.

Duke ndjekur shëmbëllin e këtyre grave heroina që kishte krijuar letërsia reflekse arbëreshe, shumë gra të kolonivet arbëreshe ndoqën shembullin e tyre në luftë bashkë me burrat kundër sundimit të urryer të Burbonëve në Kalabri; për shëmbëll plaka Rikotela, nga Vakario albanese, që strehoi vëllezërit Bandiera, ose e ëma e poetit socialist, Vinçenc Stratigoit, që u burgos bashkë me shumë gra të tjera të Ungers më 1859, se i biri kishte marrë arratinë nga ndjekjet e autoriteteve.

Dihet, se me De Radën nis edhe historia e shtypit shqiptar, dhe në organet e tija ai grumbulloi e nxiti forcat letrare të shkrimtarëve arbëreshë të rinj e të vjetër. "Fjamur i Arbërit" i De Radës u bë tribunë inkurajonjëse e të gjithë shkrimtarëve arbëreshë të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Në atë organ Gavril Darë i Riu botoi një monografi të Palac Andrianos, dhe nga faqet e Fjamurit ai mori historinë e emigracionit të arbëreshëve në Itali, që e futi pastaj duke e përdorur si dokument në prapathënien e "Kënkës së Sprasme të Balës". Zef Skiroi, i rekomanduar nga kushërira Kristina Gjella Mandala tek De Rada, nisi të shkruajë që i ri në faqet e Fjamurit. Në organin e De Radës botoi vjershat e para patriotike edhe Frano Gllaviano Krispi.

Dishepuj të De Radës qenë pothuajse të gjithë shkrimtarët arbëreshë që erdhën në kohën e tij dhe pas tij, si në përmbajtjen e veprave të tyre ashtu edhe në punën e propagandimit të çështjes shqiptare pranë opinionit të Europës. Pas gazetës së De Radës "Shqiptari i Italisë" (1848), pas "Fjamurit të Arbërit" 1883-87, një numur i madh figura intelektualësh dhe shkrimtarësh arbëreshë, duke vazhduar udhën e ndritur të De Radës, krijuan gazeta dhe revista për të luftuar për çështjen e madhe shqiptare, që kishte nisur De Rada. Pas organeve të De Radës, në Itali, duke nisur nga çereku i fundit i shek. XIX, doli një numur i madh organesh letrare e politike. Nga kongresi i gjuhësisë i Lungros 20-21 shkurt 1897, që u thirr dhe u kryesua nga De Rada, tanimë plak 83 vjeçar, u shpall vendimi që të dilte një organ letraro-politik i arbëreshëve, që të vazhdonte punën e dikurëshme të "Fjamurit të Arbërit". Dhe atë organ nisi ta drejtonte vazhdonjësi i De Radës në punën e propagandimit të çështjes shqiptare, Anselmo Lorecchio, nga 1897 gjer më 1924, ditën që vdiq. "La Nazione albanese" qe organi, që pati jetën më të gjatë në tërë historinë e shtypit shqiptar. Kjo revistë luftoi për të drejtat shqiptare me stilin e De Radës, me stilin e "Fjamurit të Arbërit".

Dihet, se Jeronim De Rada për më se gjysëm shekulli qe edhe mësonjësi i gjuhës shqipe në kolegjin italo-shqiptar të Shën Adrianit në Shën Mitër të Koronës; në atë kolegji, me fjalën e tij të zjarrtë, ai mbajti ndezur kandidilin e dashurisë për gjuhën shqipe dhe për traditat shqiptare. Nxënësit e tij që döllën nga ai kolegji, të ndezur me fjalën e tij për dashurin' e Arbërit; qenë poetë e luftëtarë të lirisë; nga ai kolegji doli nxënësi i tij i denjë poeti Zef Serembe. Nga ai kolegji doli edhe trimi guximtar arbëresh nga San Benedetto Ullano, Axhesila Milani.

Emri i De Radës na kujton sot një lëvizje të madhe letraro-politike të bashkëatdhetarëve tanë në Itali, lëvizje që pati një qëllim të vetëm: të krijonte një letërsi shqipe me frymë kombëtare, në më të shumtën e rasteve të frymëzuar nga poezia popullore dhe nga e kaluara heroike e shek. XV. dhe me anë të kësaj letërsie të bënte të njohur përpara opinionit të Europës atdheun e lashtë të arbëreshëve, tani të sunduar nga i huaji barbar, nga "kjeni turk" si e thoshin vetë arbëreshët. Frymëzonjësi dhe shpirti i kësaj

lëvizje, inisjatori i saj ka qenë pa asnjë dyshim Jeronim De Rada, kjo figurë e atdhetarit të vërtetë, që gjatë gjithë jetës së tij, në mes të gjithë asaj varfërie të madhe, punoi për lulëzimin e letërsisë shqipe me frymë kombëtare duke e ngritur atë në një dinjitet të lartë artistik dhe duke e shkruar në një shqipe të pastër si asnjëherë para tij në kohët moderne. Ai luftoi me pendën e tij për çlirimin e atdheut të lashtë dhe veçanërisht ajo që e bën edhe më të madh është, se ai luftoi kundra të gjitha tendencave imperialiste dhe shoviniste të grekëve dhe të sllavëve, të austriakëve dhe italianëve në Shqipëri, atëhere kur vendi ynë po i rrëshqiste nga duart Turqisë.

Rruga e tij u ndoq nga një rradhë shkrimtarësh arbëreshë që e pasuruan dhe e zbukuruan letërsinë shqipe në gjini të reja, duke e shkruar edhe në një gjuhë të pasur e poetike.

Për të gjitha këto Jeronim De Rada zë një vend të veçantë pionieri në historinë e mendimit shqiptar, në historinë e kulturës shqiptare të re të shek. XIX.

Rilindasit tonë, të shpërndarë nëpër kolonitë e ndryshme të Europës juglindore, e ndoqën me interes e dashuri këtë punë prej pionieri të De Radës dhe shumë prej tyre edhe e përgëzuan personalisht.

Jeronim De Rada vdiq në një dhomë si podrum të Shën Mitrit, duke marrë me vete dhëmbjen që s'e pa të lirë dhe të pavarur Shqipërinë e tij, Arbërin e tij.

Më 1902, një vit para se të vdiste poeti, Mikel Markjanoi u shpreh kështu: "Këtij burri, atdheu mirënjohës, si të bëhet i lirë, do t'i ngrejë një përmendore, që të kujtojë veprën e tij, që të përjetësojë mendimin e tij, se që mendim i rigjenerimit dhe i çlirimit të tij". Këto fjalë u bënë realitet vetëm sot nën pushtetin popullor, kur me të vërtetë, më 26 nëndor të vitit 1962, me rastin e pesëdhjetëvjetorit të pavarësisë, populli shqiptar i ngriti bustin Jeronim De Radës. Busti i De Radës, me fytyrën e tij fisnike, të ngritur mbi një pedestal të lartë, zbukuron sot një nga sheshet e reja të Tiranës, nga ku poeti, me shikimin e tij drejt kodrinave të bukura të kryeqytetit sodit plot optimizmë të ardhmen e lumtur të atdheut të tij të lashtë, që ai e deshë kaqë fort dhe për të cilin sakrifikoi gjithçka.

Ne sot në Shqipërinë socialiste kemi një respekt të veçantë për poetin e parë të madh të kombit dhe figurën e tij e kemi vënë pranë figurave të mëdha të Rilindjes sonë kombëtare. Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka nderuar De Radën me Urdhërin e Lirisë të klasit të parë dhe post mortem "Mësonjës të popullit".

R é s u m é

JERONIM DE RADA COMME FOLKLORISTE ET POÈTE
ET SON INFLUENCE SUR LES ECRIVAINS ARBËRESH DES S.
XIX-XX

Jeronim De Rada est le véritable créateur de la littérature artistique albanaise d'inspiration nationale. Il a été celui qui a fait scinder celle-ci du contenu mystique et religieux qu'avait notre littérature jusqu'à la fin du XVIII^es.

Saisi par le contenu de la poésie populaire arbëresh, notamment par les chants épiques, historiques et légendaires chantant la prouesse albanaise du XV^e siècle sous Skanderbeg, il fit une vaste moisson de ces traditions. Leur publication fit attirer l'attention de l'opinion publique de l'Europe sur le génie créateur du peuple albanaise au cours des âges, et notamment au cours du XV^es.

La publication des Rhapsodies de De Rada en 1866 à Florence fut une excellente incitation pour d'autres Arbëresh à recueillir et faire publier le trésor populaire. Et, après les Rhapsodies de De Rada, au cours du XIX^e-commencement du XX^e s. virent le jour de nombreux recueils folkloriques édités par des Albanaïes et des Arrbëresh. C'est en cela que réside le premier grand mérite de De Rada.

S'inspirant à la poésie épico-léendaire recueillie, De Rada créa plusieurs oeuvres lyrico-épiques, qui ont toutes pour sujet l'époque et la figure de Skanderbeg. Celui-ci, en élevant la voix contre le contenu de la littérature religieuse du passé, demanda d'écrire des oeuvres héroïques, servant à l'éducation de la population albanaise par le sentiment de rattachement à la Patrie. Et vraiment ses Chants de Milosao, Skanderbeg l'infortuné, Séraphine Thopia, Un miroir de transition humaine considèrent très haut l'héroïsme du peuple albanaïes pendant la guerre contre l'empire turc au XV^e s.

Le chemin ouvert par l'éminent poète de Makji fait école: il fut suivi par tous les écrivains arbëresh venus à sa suite au XIX^e -commencement du XX^e s. Nous nommerons dans cet ordre Le dernier chant de Bale de Gavril Dara le jeune, écrit avant 1885, les oeuvres de Zef Schirò senior, telles Rhapsodies albanaïes, Mili et Hajdhia et En terre étrangère écrites entre 1887 et 1900, les poésies patriotiques de Zef Serembe, les poésies patriotiques le poème Sur le mont des Roses de Frano Glaviano Krispi. Toutes ces oeuvres sont une évocation d'un passé plein de gloire du peuple albanaïes au XV^e siècle.

Tous ces écrivains arbëresh, en suivant les traces de De Rada dans la restitution aux lettres de la poésie populaire et en dressant sur ses modèles leurs oeuvres, ont connu des résultats brillants, enrichissant ainsi la littérature moderne arbëresh comme thématique et comme figures.

De Rada a écrit toutes les oeuvres poétiques dans une forme populaire, en empruntant le vers populaire des rhapsodies, le septenaire et l'octonaire trocäïque. Il déclarait d'avoir emprunté cette forme, du fait que toutes les belles lettres l'ont à la base de leur poésie populaire. Comme exemple il donnait les poèmes homériques.

A peu d'exceptions près, aussi les poètes arbëresh venus après de Rada, ont utilisé dans leurs oeuvres le vers populaire, sans rime.

Ainsi, la voie ouverte par De Rada dans l'évaluation de la poésie populaire, en écrivant ses oeuvres sur son modèle, a représenté un véritable succès pour la littérature arbëresh du XIX^e s., un succès aussi grand, que ces oeuvres ont reçu le meilleur accueil de la critique littéraire de l'Europe.